

VENDIM
Nr.330, datë 13.5.2005

**PËR SIGURIMIN E TË DHËNAVE PËR PRONAT PUBLIKE DHE PRIVATE, NË
FUNKSION TË REALIZIMIT TË PROCESIT TË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË
TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucionet që administrojnë prona shtetërore si tokë bujqësore, tokë pyjore, pyje, livadhe, kullota, troje dhe ndërtesa, në kuadër të inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, të përcaktojnë listën e pronave shtetërore, të shpronësuara, pas datës 29.11.1944, të personave fizikë e juridikë, privatë, të cilat nuk përdoren për qëllim të shpronësimit, dhe ta vënë atë në dispozicion të Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave.

Kur institucioni ka vendosur të heqë dorë nga administrimi i një prone shtetërore nuk mund ta kalojë atë në administrim apo pronësi të një institucioni tjetër shtetëror, pa marrë, paraprakisht, mendimin e Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave.

2. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të vërë në dispozicion të Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave, këto dokumente:

- Hartat e zonave, që kanë përparësi zhvillimin e turizmit;
- Mastërplanet e studimeve të zonave turistike, për një periudhë afatmesme 10-vjeçare;
- Të dhëna të hollësishme për fshatrat turistikë të ndërtuar, në ndërtim apo të projektuar për t'u ndërtuar në zonën turistike, vendndodhjen e tyre, dhe sipërfaqet e zëna.

3. Për rastet kur, pas verifikimit të pronave shtetërore nga komisionet vendore, rezulton se ndonjëra nga këto prona ka pronar dhe përmbush kushtet e parashikuara në paragrafin e parë, të pikës 1 të këtij vendimi, atëherë Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe i Kompensimit të Pronave, brenda 2 muajve, i kërkon institucionit shtetëror përkatës, që administron pronën, t'i propozojë Ministrisë së Ekonomisë fillimin e procedurave për privatizimin e saj.

Ministria e Ekonomisë, për objektet shtetërore, për të cilat duhet të fillojnë procedurat e privatizimit, duhet të vërë në dijeni, paraprakisht, Komitetin Shtetëror të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave, i cili brenda dy muajve, duhet të japë përgjigje për pronësinë e tokës, me qëllim garantimin e ushtrimit të së drejtës së parablerjes nga ish-pronari.

4. Të gjitha institucionet shtetërore, që zotërojnë dokumentacion për shpronësimet e bëra nga shteti pas datës 29 nëntor 1944, t'ia vënë atë në dispozicion Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të shoqëruar me këto të dhëna:

- Listën e subjekteve të shpronësuara, pronat e të cilave vazhdojnë të përdoren për interesa publike;
- Listën e personave, që ia kanë dhuruar pronat e tyre shtetit, veprim për të cilin ka dokumente zyrtare;
- Listën e subjekteve të shpronësuara, pronat e të cilave janë përmbytur nga ndërtimi i hidrocentraleve, e që janë kompensuar sipas dispozitave për shpronësimet për interes publik.

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (Arkivi Qendror i Shtetit) duhet të paraqesë dokumentacionin ndihmës pranë ministrive dhe institucioneve, sipas kërkesave të tyre, për verifikimin e gjendjes së pronave në administrim të tyre e të atyre të shpronësuara, pas datës 29 nëntor 1944, të personave fizikë, privatë.

5. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano